

**L I G J I**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT**  
**PËR FAMILJE**

Neni 1

Në Ligjin për familje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 80/92 dhe 9/96) neni 1 ndryshon si vijon:  
"Me këtë ligj rregullohen: martesë dhe familja, marrëdhëniet në martesë dhe familje, forma të caktuara të mbrojtjes së posaçme të familjes, marrëdhëniet e prishura dhe dhuna në martesë dhe në familje, adoptimi, tutoria, mbajtja, si dhe procedura para gjyqit në kontestet martesore dhe familjare."

Neni 2

Në nenin 4 shtohet paragraf i ri 2 si vijon:  
"Republika siguron mbrojtjen e martesës dhe të familjes nga marrëdhëniet e prishura dhe dhuna në martesë dhe familje."

Neni 3

Në nenin 14 në paragrafin 1 pas fjalës "familje", shtohen fjalët: "dhunë në martesë dhe familje, një pjesë e punëve të lidhura me".

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2 si vijon:

"Për punët nga paragrafi 1 i këtij neni që kanë të bëjnë me adoptimin vendos Komisioni për themelimin e adoptimit pranë Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni)."

Në paragrafin 2 që bëhet paragraf 3 pas fjalëve: "Qendra e Punës Sociale" shtohen fjalët: "edhe Komisioni", ndërsa fjala "zbaton" zëvendësohet me fjalën "zëvendësojnë".

Pas paragrafit 3 i cili bëhet paragraf 4 shtohet paragraf i ri 5, si vijon:

"Për ankesat e bëra kundër vendimeve të Komisionit vendos komisioni përkatës për çështje nga politika sociale pranë Qeverisë së Republikës të Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni pranë Qeverisë së Republikës të Maqedonisë)."

Paragrafi 4 i cili bëhet paragraf 6 ndryshon si vijon:

"Ankesat e bëra kundër vendimeve të qendrës së punës sociale dhe Komisionit, nuk e ndalin zbatimin e tyre."

Neni 4

Pas nenit 14 shtohen dy nene të reja 14-a dhe 14-b si vijojnë:

"Neni 14-a

Autorizimin për zbatimin e ekzekutimit të vendimeve të qendrës së punës sociale, personi zyrtar e dëshmon me legjimitacion.

Legjimitacionin, personit zyrtar ia jep ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Formularin e legjimitacionit të personit zyrtar dhe mënyrën e dhënies së tij e cakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 14-b

Numrin e ekzekutuesve dhe të autorizimeve që i kanë ekzekutuesit, i cakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale."

Neni 5

Pas nenit 33 shtohet nen i ri 33-a si vijon:

"Neni 33-a

Ndalohet çdo lloj dhune në martesë dhe familje."

Neni 6

Në nenin 46 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2 si vijon:

"Fëmija ka të drejtë për kujdes nga prindërit e tij, të mbrohet jeta dhe shëndeti i tij, të jetë i aftë për jetë dhe punë të pavarur, t'i sigurohen kushte optimale për edukimin, shkollimin dhe aftësimin e tij profesional, varësisht nga kushtet e familjes."

Neni 7

Në nenin 47 pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3 si vijon:

"Fëmija ka të drejtë të mbajë marrëdhënie dhe kontakte të drejtpërdrejta personale me prindin me të cilin nuk jeton."

Në paragrafin 3, i cili bëhet paragraf 4 pas fjalës "marrëdhënie" shtohen fjalët: "edhe kontakte të drejtpërdrejta".

Neni 8

Në nenin 48 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Fëmija ka të drejtë të përfaqësohet nga prindërit ose nga tutorët e tij."

Neni 9

Në nenin 56 në paragrafin 3 pas fjalës "të zhdukur", shtohen fjalët "me adresë të panjohur ose me aftësi të kufizuar ose me aftësi të humbur veprimi,".

Neni 10

Në nenin 79 paragrafi 1 në fjalinë e parë pas fjalës "marrëdhënie" shtohen fjalët: "dhe kontakte të drejtpërdrejta", ndërsa fjalia e dytë zëvendësohet me fjali të re, si vijon:

"Nëse prindërit e fëmijës në një afat prej më së shumti dy muajsh nuk pajtohen me mënyrën e mbajtjes së marrëdhënieve dhe kontakteve të drejtpërdrejta personale me fëmijën, qendra e punës sociale merr vendim për të."

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Gjatë caktimit të marrëdhënieve dhe kontakteve të drejtpërdrejta personale të fëmijës me prindin, qendra e punës sociale e informon fëmijën dhe i merr parasysh qëndrimet dhe mendimet e tij, varësisht nga moshë dhe shkalla e zhvillimit dhe e informon për pasojat e mundshme të vendimeve."

Në paragrafët 2 dhe 3 pas fjalës "marrëdhënie" shtohen fjalët: "edhe kontakte të drejtpërdrejta".

Paragrafët 2, 3 dhe 4 bëhen paragrafë 3, 4 dhe 5.

Neni 11

Në nenin 80 paragrafi 3 pas fjalës "marrëdhënie" shtohen fjalët "edhe kontakte të drejtpërdrejta".

Neni 12

Në nenin 82 pas fjalës "marrëdhënie" shtohen fjalët "edhe kontakte të drejtpërdrejta".

Neni 13

Në nenin 87 pas paragrafit 1 shtohen 4 paragrafë të rinj 2, 3, 4 dhe 5, si vijojnë:

"Qendra e punës sociale mund të marrë vendim me të cilin prindit, i cili më shumë se 3 muaj nuk ka dhënë kontributin për mbajtjen e fëmijës, do t'ia kufizojë të drejtën që të mbajë marrëdhënie personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me fëmijën, përderisa nuk i kryen obligimet ndaj fëmijës.

Qendra e punës sociale do të marrë vendim me të cilin, prindit të cilit fëmija nuk i është besuar për ruajtje dhe edukim, do t'ia kufizojë të drejtën për mbajtjen e marrëdhënieve dhe kontakteve personale me fëmijën, përderisa pa arsye, më se 3 herë pandërprerë, nuk e ka respektuar vendimin e qendrës së punës sociale.

Qendra e punës sociale mund të marrë vendim me të cilin do ta japë fëmijën në qëndrim te prindi të cilit fëmija nuk i është besuar për ruajtje dhe edukim, për një periudhë të caktuar kohore por jo më shumë se 15 ditë, nëse më se dy herë radhazi prindi tjetër pa arsye nuk e ka respektuar vendimin e qendrës të punës sociale.

Qendra e punës sociale do të marrë vendim me të cilin prindit do t'ia kufizojë të drejtën e mbajtjes së marrëdhënieve dhe kontakteve personale me fëmijën ose të njëjtat do t'ia ndalojë për një periudhë të caktuar kohore,

por jo më shumë se 6 muaj, nëse në afat të caktuar me vendim nuk e ka kthyer fëmijën ose e ka mbajtur më gjatë nga koha e caktuar me vendim, ose e ka dërguar në drejtim të panjohur."

Paragrafi 2 i cili bëhet paragraf 6 ndryshon si vijon:

"Qendra e punës sociale do të marrë vendim me të cilin përkohësisht do t'ia besojë fëmijën prindit tjetër, personit të tretë ose do ta vendosë në familje tjetër ose në institucion përkatës, si zgjedhje e fundit, nëse ka njohuri se marrëdhëniet personale dhe kontaktet e drejtpërdrejta të fëmijës janë ndërprerë më shumë se dy muaj për shkak të mosveprimit sipas vendimit të qendrës së punës sociale të prindit të cilit fëmija i është besuar ose për shkak të marrëdhënieve të prishura të partnerëve, që shprehen dëmshëm në zhvillimin e fëmijës."

Pas paragrafit 3 i cili bëhet paragraf 7 shtohet paragrafi i ri 8, si vijon:

"Në rastet e paragrafëve 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij neni, qendra e punës sociale i obligon prindërit ta vizitojnë këshillimoren përkatëse."

Paragrafi 4 bëhet paragraf 9.

#### Neni 14

Në nenin 90 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2 si vijon:

"Si keqpërdorim ose mospërfillje e rëndë e obligimeve prindërore në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, do të konsiderohet nëse prindi:

- ushtron dhunë fizike ose emocionale ndaj fëmijës;
- fëmijën e shfrytëzon seksualisht;
- e detyron fëmijën në punë që nuk i përshtatet moshës së tij;
- ia lejon përdorimin e alkoolit, drogës ose substancave të tjera psikotropike;
- e vë fëmijën para sjelljeve të papranueshme familjare;
- e ka lëshuar fëmijën dhe më shumë se tre muaj nuk kujdeset për fëmijën; dhe
- nëse në çfarëdo mënyre tjetër i shkel rëndë të drejtat e fëmijës."

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

#### Neni 15

Pas nenit 94 shtohet kapitulli i ri VI-A "Marrëdhënie të prishura dhe dhuna në martesë dhe familje" dhe 12 nene të reja neni 94-a, 94-b, 94-v, 94-g, 94-d, 94-gj, 94-e, 94-zh, 94-z, 94-x, 94-i dhe 94-j, si vijojnë:

#### "VI-a

Marrëdhënie të prishura dhe dhunë në martesë dhe familje

#### Neni 94-a

Personat që janë në martesë, prekatësisht familja janë të obliguar të respektohen, të ndihmohen dhe të mbrohen në mënyrë të ndërsjelltë.

#### Neni 94-b

Ndalohet çdo lloj dhune ndërmjet anëtarëve të familjes, pa dallim gjinie dhe moshe.

Me dhunë në martesë dhe familje (në tekstin e mëtejshëm: dhunë familjare) nga paragrafi 1 i këtij neni, konsiderohet sjellja e anëtarit të familjes që me ushtrimin e forcës, kërcënimit dhe frikësimit bën lëndim trupor, keqpërdorim emocional ose seksual dhe material, seksual ose pune së anëtarit tjetër të familjes.

Si dhunë nga paragrafi 2 i këtij neni, llogaritet sjellja e bërë :

- e njërit prej bashkëshortëve ndaj bashkëshortit tjetër, të cilët jetojnë ose kanë jetuar në bashkësi martesore, ose jashtëmartesore ose në çfarëdo bashkësie si familje ose nëse kanë fëmijë të përbashkët;
- ndërmjet vëllezërve dhe motrave, vëllezërve prej babe ose prej nëne dhe motrave prej babe ose prej nëne;
- ndaj fëmijës;
- ndaj anëtarëve më të vjetër në familje dhe
- ndaj personave-anëtarë të familjes aftësia e veprimit të cilëve është marrë pjesërisht ose plotësisht.

#### Neni 94-v

Viktimë e dhunës familjare mund të jetë cilido anëtar i familjes, pa dallim gjinie dhe moshe.

Ushtrues i dhunës familjare mund të jetë: bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor, ish-bashkëshorti apo ish-bashkëshorti jashtëmartesor, personi që banon ose që ka banuar në bashkësi me personin viktimë e dhunës martesore, personi me të cilin ka fëmijë të përbashkët ose personi që është i lidhur deri në brezin e katërt të lidhjes së gjakut apo brezit të dytë sipas krushqisë me këta persona, ose që janë me ata në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose në lloj tjetër të bashkësisë së jetesës.

#### Neni 94-g

Qendra për punë sociale, çdoherë kur ka njohuri se në familje janë të prishura marrëdhëniet familjare ose ka dhunë familjare, vetë ose me kërkesë të anëtarit të familjes ndërmerr masa për mbrojtjen e familjes dhe personave që janë viktimë e dhunës familjare.

Qendra për punë sociale, çdoherë kur ka njohuri se në familje ekziston dhunë familjare ndaj fëmijës së mitur ose personit aftësia e veprimit të të cilit është e kufizuar ose është marrë, ndërmerr masa për mbrojtje.

Njohuritë nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Qendra për punë sociale i merr nga qytetarët, personat zyrtar dhe juridik të cilët janë të obliguar që pa shtyrje ta njoftojnë Qendrën për njohuri të këtuilla.

Qendra për punë sociale kur ka njohuri se në familje ekziston dhunë familjare i ndërmerr aktivitetet vijuese për mbrojtje:

- 1) siguron vendosje të domosdoshme për personin-viktimë e dhunës, që mund të zgjasë më së shumti 6 muaj, me mundësi për vazhdim për 6 muaj.
- 2) siguron mbrojtje përkatëse shëndetësore;
- 3) siguron intevenim përkatës psiko-social dhe trajtim;
- 4) i udhëzon në këshillimore përkatëse;
- 5) nëse në familje ka fëmijë që është në shkollim të rregullt, ndihmon për vazhdimin e shkollimit të rregullt;
- 6) e lajmëron organin për ndjekje;
- 7) ofron çdo lloj ndihme juridike dhe përfaqësim;
- 8) ngre procedurë para gjykatës kompetente;
- 9) sipas nevojës i parashtrohet kërkesë gjykatës për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje; dhe
- 10) ndërmerr masa të tjera për të cilat do të vlerësojë se janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemit.

Qendra për punë sociale i ndërmerr masat nga paragrafi 4 i këtij neni kur ushtrues i dhunës familjare është ndonjëri prej personave të përcaktuar në nenin 94-v të këtij ligji.

#### Neni 94-d

Qendra për punë sociale do t'i parashtrojë kërkesë për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare, gjykatës për persona të mitur dhe persona pa aftësi veprimi, çdo herë kur prindi, tutori ose përfaqësuesi ligjor atë nuk do ta bëjnë.

Qendra për punë sociale, kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, për personat e moshës madhore dhe personat pa aftësi veprimi, do t'ia paraqesë gjykatës, vetëm me pëlqim të viktimës së dhunës familjare.

#### Neni 94-gj

Qendra për punë sociale, kërkesës nga neni 94-d të këtij ligji ia bashkangjet procesverbalin dhe raportin për veprimet e ndërmarra, ku mund të japë edhe propozim për shqiptimin e masës së përkohshme me propozimmasë.

#### Neni 94-e

Qendra për punë sociale, nëse ka njohuri se janë kryer veprime nga neni 94-b të këtij ligji, i paraqet kërkesë gjykatës kompetente për shqiptimin e masës së përkohshme, me të cilën gjykata ka mundësi që kryerësit të dhunës familjare t'i;

- 1) ndalojë të kërcënohet se do të bëjë dhunë familjare;
- 2) ndalojë të maltretojë, shqetësojë, telefonojë, kontaktojë ose të komunikojë në mënyrë tjetër me anëtarët e familjes, në mënyrë direkte apo indirekte;

3) ndalojë t'i afrohet vendbanimit, shkollës, vendit të punës ose vendit të caktuar të cilin rregullisht e viziton anëtar i tjetër i familjes;

4) caktojë largimin nga shtëpia pa marrë parasysh pronën, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente;

5) ndalojë të posedojë armë zjarri ose armë tjetër ose e njëjta t'i merret;

6) e obligon t'i kthejë sendet që janë të nevojshme për plotësimin e nevojave të përditshme të familjes;

7) shqiptojë mbajtjen e obligueshme të familjes;

8) urdhërojë që i akuzuari ta vizitojë këshillimoren përkatëse;

9) urdhërojë shërim të detyrueshëm, nëse shfrytëzuesi është në ndikim të alkoolit dhe substancave të tjera psikotropike ose ka ndonjë sëmundje;

10) detyrojë të bëjë kompensimin e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera të bëra nga dhuna familjare, dhe

11) shqiptojë çfarëdo lloj mase tjetër që gjykata do ta konsiderojë si të domosdoshme që të sigurohet mbrojtja dhe mirëqenia e anëtarëve të tjerë të familjes.

#### Neni 94-zh

Propozim për shqiptimin e masës së përkohshme mund të paraqesë bashkëshorti, prindërit ose fëmijët ose persona të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose bashkësi familjare, ish-bashkëshortë ose persona që gjenden në marrëdhënie të afërta personale, ndaj të cilëve janë ndërmarrë veprime të dhunës familjare, pa marrë parasysh se a është parashtruar padi në procedurë penale.

Prindi, tutori ose përfaqësuesi ligjor mund të paraqesë propozim në emër të fëmijës së mitur ose personit me aftësi të kufizuar veprimi, si dhe për person për të cilin është vazhduar e drejta prindore.

Propozimin nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni personat ia dërgojnë qendrës kompetente për punë sociale sipas vendbanimit të viktimës së dhunës familjare.

#### Neni 94-z

Masa e përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare mund të zgjasë më së shumti një vit.

Nëse dhuna familjare vazhdon edhe pas kalimit të masës nga neni 94-e i këtij ligji, qendra për punë sociale mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e njëres prej masave.

#### Neni 94-x

Qendra për punë sociale e përcjell ekzekutimin e masës së shqiptuar dhe për zhvillimin e zbatimit të masës së shqiptuar e lajmëron gjykatën me kërkesë të saj.

#### Neni 94-i

Qendra për punë sociale mund t'i paraqesë propozim gjykatës kompetente për suprimimin e masës së shqiptuar edhe para skadimit të afatit për të cilin është shqiptuar masa, nëse vlerëson se e njëjta e ka arritur qëllimin për të cilin është shqiptuar.

Qendra për punë sociale mund të paraqesë propozim për ndryshimin e masës së shqiptuar ose për vazhdimin e saj, nëse vlerëson se masa e shqiptuar është joadekuatë ose se do t'i arrijë rezultatet e kërkuara, por për atë është e nevojshme që e njëjta të zgjasë një periudhë më gjatë kohore.

#### Neni 94-j

Në zbatimin e masave mbrojtëse, qendra për punë sociale bashkëpunon me qytetarë, persona juridik dhe organizata."

#### Neni 16

Në nenin 95 paragrafi 2 fjala "dhjetë" zëvendësohet me fjalën "dymbëdhjetë".

#### Neni 17

Në nenin 97 në paragrafin 1 pas fjalës "në" shtohen fjalët: "në pajtim me më të mirin" ndërsa në paragrafin 2 fjalët: "qendra për punë sociale" zëvendësohet me fjalën "Komisioni".

Pas nenit 97 shtohen tri nene të reja 97-a, 97-b dhe 97-v, si vijojnë:

#### "Neni 97-a

Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, të emëruar nga ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Anëtar i Komisionit mund të jetë personi që punon së paku 15 vjet në lëmin dhe që është dalluar në punë.

Komisioni në përbërjen e tij domosdo duhet të ketë: jurist, pedagog, psikolog dhe punëtor social.

Mandati i anëtarëve të Komisionit është 5 vjet.

Mbledhjen konstitutive të Komisionit e konvokon ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

Kryetari i Komisionit zgjedhet nga anëtarët e Komisionit me mandat prej 1 viti.

Komisioni punon në mënyrë të pavarur dhe vendimet i merr njëzërit.

Komisioni miraton rregullore për punë.

Komisioni për punën e vet çdo tre muaj e informon, ndërsa çdo vit i paraqet raport për punën e vet ministrit të Punës dhe Politikës Sociale.

#### Neni 97-b

Punët administrative teknike të Komisionit i kryen person nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

#### Neni 97-v

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me akt i cakton lartësinë dhe mënyrën e pagesës së kompensimit të shpenzimeve reale të bëra në procedurën për adoptim.

#### Neni 18

Në nenin 99 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

"Në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni është e nevojshme të grumbullohen ekstrakte nga ligji që ka të bëjë me përvetësimin e tokës së përvetësuesve dhe informata e dëshmi të tjera që të sigurohen së paku kushte të barabarta ose më të mira për jetën dhe zhvillimin e fëmijës."

Në paragrafin 3 që bëhet paragraf 4 fjala "leje" zëvendësohet me fjalën "pajtueshmëri", ndërsa fjalët: "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohet me fjalën "Komisioni".

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 5, si vijon:

"Pajtueshmëria nga paragrafi 4 i këtij neni do të jepet vetëm nëse fëmija nuk mund të adoptohet në territorin e Republikës së Maqedonisë."

#### Neni 19

Neni 100 zëvendësohet me tri nene të reja 100-a, 100-b dhe 100-v, si vijojnë:

#### "Neni 100-a

Adoptues mund të jetë personi që ka aftësi për punë, që ka cilësi personale për kryerjen e suksesshme të të drejtave prindore dhe të mos jetë më i moshuar se 45 vjet.

Adoptues mund të jetë personi që është së paku 18 vjet më i moshuar se i adoptuari.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni si adoptues mund të paraqitet edhe personi që është më i moshuar se 45 vjet, por kufiri i moshës ndërmjet adoptuesit dhe të adoptuarit nuk guxon të jetë më e madhe se 45 vite.

Bashkëshortët mund të paraqiten si adoptues nëse njëri prej tyre nuk e kalon kufirin e lartë të moshës.

#### Neni 100-b

Kur fëmijën e adopton bashkëshorti i prindit të fëmijës, fëmija mund të adoptohet pa dallim të kufirit të moshës së përcaktuar në nenin 100-a të këtij ligji.

## Neni 100-v

Me përjashtim të nenit 100-a paragrafi 1 dhe 4 të këtij ligji, si adoptues mund të paraqitet edhe personi ose bashkëshortë që e kalojnë kufirin e lartë të moshës, nëse adoptohet vëlla ose motër e fëmijës që është adoptuar."

## Neni 20

Në nenin 102 paragrafi 1 pika a) zëvendësohet me pikë të re a) si vijon:

"që i është marrë ose përkufizuar e drejta prindore, si dhe personit që i është shqiptuar dënim për vepër të kryer penale me dënim efektiv me burg në kohëzgjatje mbi 6 muaj", lidhëza "dhe" në fund të pikës v) zëvendësohet me presje, në pikën g) fjala "psikik" zëvendësohet me fjalën "intelektual", ndërsa pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohen pika të reja "d", "gj", "e", "zh" dhe "z", si vijojnë:

"d) pengesa fizike e të cilit është e asaj shkalle që ka mundësi me arsye të dyshohet në mundësinë që të kujdeset për fëmijën;

gj) nëse është më i moshuar se 45 vjet;

e) i varur nga droga ose substanca tjera psikotropike ose alkool;

zh) që ka sëmundje të rëndë kronike ose është i sëmurë nga ndonjë sëmundje ngjitëse e pashërueshme, dhe

z) nëse mendimi i ekipit profesional të qendrës për punë sociale është negativ lidhur me mundësinë që ata persona të jenë prindër."

## Neni 21

Në nenin 103 paragrafin 1 fjala "dhjetë" zëvendësohet me fjalën "dymbëdhjetë".

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Nëse prindi është i mitur, përveç pajtueshmërisë së tij merret edhe pajtimi nga përfaqësuesi ligjor."

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

"Nuk nevojitet pajtueshmëri as nga prindi i fëmijës së vendosur në institucion ose në familje tjetër që nuk ka shprehur interes për fëmijën më shumë se 6 muaj nga afati që ka qenë i obligueshëm ta marrë fëmijën."

Në paragrafin 3 fjala "dhjetëvjeçare" zëvendësohet me fjalën "dymbëdhjetëvjeçare".

Në paragrafin 4 fjala "prindi" zëvendësohet me fjalët: "personi të cilin nëna e ka deklaruar si prind".

Paragrafët 3 dhe 4 bëhen paragrafë 5 dhe 6.

## Neni 22

Në nenin 104 në paragrafin 1 pas fjalëve: "kërkesë deri te" shtohet fjala "Komisioni", ndërsa fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Validiteti i dokumenteve nga paragrafi 2 i këtij neni është një vit."

Paragrafët 3 dhe 4 fshihen.

## Neni 23

Pas nenit 104 shtohen 12 nene të reja 104-a, 104-b, 104-v, 104-g, 104-d, 104-gj, 104-e, 104-zh, 104-z, 104-x, 104-i dhe 104-j, si vijojnë:

## "Neni 104-a

Pas pranimit të kërkesës me dokumentet, Komisioni bën kontrollimin e dokumenteve dhe pasi të konstatojë se janë plotësuar kushtet nga neni 104 paragrafi 2 i këtij ligji, kopja e kërkesës së bashku me kopjen e tërë lëndës, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, ia dorëzon qendrës për punë sociale, kompetente sipas vendbanimit të parashtruesit të kërkesës.

Komisioni nëse nga vlerësimi i bërë i dokumenteve vërteton se nuk janë të plotësuar kushtet nga neni 102 i këtij ligji, do të marrë vendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën.

## Neni 104-b

Qendra për punë sociale te e cila është dërguar kërkesa, bën vlerësimin për përshtatshmërinë e adoptuesve dhe për motivet e adoptimit, nëpërmjet përcjelljes së kontinuar të adoptuesve potencialë, së paku gjashtë muaj, por jo më shumë se një vit dhe në bazë të ekspertizës dhe mendimit të ekipit profesional, përgatit propozim për regjistrim në regjistrin e adoptuesve të mundshëm.

## Neni 104-v

Në afatin e përcaktuar në nenin 104-b të këtij ligji, personat që dëshirojnë të adoptojnë fëmijë, mund të dërgohen të ndjekin këshillimore përkatëse.

Mënyrën e punës të këshillimores nga paragrafi 1 i këtij neni me akt e përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

## Neni 104-g

Qendra për punë sociale pas kryerjes së punëve nga neni 104-b i këtij ligji, të gjitha dokumentet së bashku me ekspertizën dhe mendimin e ekipit profesional me propozimin për regjistrim në regjistrin e adoptuesve të mundshëm ia dërgon Komisionit.

## Neni 104-d

Komisioni në afat prej 30 ditësh, por jo më shumë se 60 ditë, nga dita e pranimit të punëve nga neni 104-g të këtij ligji, merr vendim dhe bën regjistrimin në regjistrin të adoptuesve të mundshëm nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara me këtë ligj ose do ta kthejë lëndën në ripunim dhe do të caktojë afat në të cilin qendra kompetente për punë sociale është e obliguar të veprojë dhe t'i evitojë lëshimet, nëse ai vetë nuk e bën atë.

Komisioni do të marrë vendim për shlyerje nga regjistrin i adoptuesve të mundshëm, pas themelimit të adoptimit, nëse krijohet një nga kushtet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji edhe nga shkaku i vdekjes së adoptuesit.

## Neni 104-gj

Qendra për punë sociale i përcjell personat e mitur pa prindër dhe përkujdesje prindore dhe jep propozim për regjistrim në regjistrin për të adoptuar të mundshëm, të cilin ia dërgon Komisionit.

Propozimin nga paragrafi 1 i këtij neni, së bashku me ekspertizën dhe mendimin nga ekipi profesional dhe ekspertizat individuale dhe mendimet e punëtorëve profesional, qendra për punë sociale ia dërgon Komisionit, i cili është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të çështjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, të bëjë regjistrimin e të adoptuarve të mundshëm.

Komisioni do të marrë vendim për shlyerje nga regjistrin i të adoptuarve të mundshëm, pas themelimit të adoptimit, nëse prindi e tërheq pajtueshmërinë nga neni 107 të këtij ligji dhe nga shkaku i vdekjes së të adoptuarit.

## Neni 104-e

Ministri i Punës dhe i Politikës Sociale me akt e rregullon formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave të adoptuesve të mundshëm dhe të adoptuarve të mundshëm.

## Neni 104-zh

Komisioni gjithmonë ka mundësi të bëjë kontrollimin e bazueshmërisë së propozimit nga neni 104-g dhe 104-gj të këtij ligji të qendrës për punë sociale.

## Neni 104-z

Komisioni, ekzemplarën e vendimit dhe ekstraktin nga regjistrat nga neni 104-g dhe 104-gj të këtij ligji, së bashku me kopjen e dokumentacionit të përgjithshëm menjëherë ia dërgon qendrës kompetente për punë sociale, kurse paraqitësin e kërkesës e njofton për regjistrimin e bërë.

## Neni 104-x

Qendra për punë sociale pas pranimit të punëve nga neni 104-z të këtij ligji, propozon adoptuesit më përkatës dhe propozim për vendosjen e fëmijës në familjen e adoptuesve të mundshëm, ia dërgon Komisionit.

Komisioni mund të bëjë kontrollimin e bazueshmërisë së propozimit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe në bazë të të dhënave që i ka në regjistër për adoptuesit e mundshëm dhe dokumentet, mund të vendosë që fëmijën ta vendosë në familje tjetër.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me akt i rregullon kushtet dhe kriteret më të përafërta për zgjedhjen e adoptuesve.

## Neni 104-i

Komisioni, pas punëve të kryera nga neni 104-x të këtij ligji, merr vendim për vendosjen e fëmijës në familjen e adoptuesve dhe kopjet e ekstrakteve të adoptuesve të mundshëm dhe të adoptuarit, menjëherë ia dërgon qendrës për punë sociale, kompetente sipas vendbanimit të adoptuesve të mundshëm.

Në vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni, gjatë adoptimit të plotë, futen të dhëna për datën dhe vendlindjen e fëmijës, prej të cilave nuk mund të zblulohet identiteti i prindërve të fëmijës.

Vendosja e fëmijës nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtër se 6 muaj, as më e gjatë se 9 muaj.

Qendra për punë sociale është e obliguar që në mënyrë të kontinuar ta përcjellë vendosjen e fëmijës dhe çdo tre muaj t'i paraqesë raport Komisionit.

Komisioni mundet që në afatin e caktuar në paragrafin 3 të këtij neni, çdoherë kur të vlerësojë të nevojshme, ta kontrollojë familjen ku është i vendosur fëmija.

## Neni 104-j

Qendra për punë sociale pas kalimit të periudhës së vendosjes, përgatit raport për vendosjen dhe jep mendim që fëmija të adoptohet nga adoptues konkretë dhe të njëjtin ia dërgon Komisionit për shkak të themelimit të adoptimit.

Komisioni, nëse nga kontrolli në regjistrat vlerëson se propozimi i qendrës për punë sociale nuk është në interes të fëmijës, të njëjtin mund ta refuzojë ose lëndën ta kthejë për plotësimin e procedurës ose të propozojë adoptues të tjerë.

Komisioni në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, merr vendim për themelimin e adoptimit."

## Neni 24

Në nenin 105 paragrafin 1 fjala "dhjetë" zëvendësohet me fjalën "dymbëdhjetë", ndërsa numri "3" zëvendësohet me numrin "5".

## Neni 25

Në nenin 106 pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, si vijon:

"Nëse fëmija nuk ka prindër të gjallë, pajtimin që të adoptohet e japin farefisi i brezit të parë ose tutori."

Paragrafët 2, 3 dhe 4 bëhen paragrafë 3, 4 dhe 5.

Pas paragrafit 4 shtohet paragrafi i ri 6, si vijon:

"Para se prindi të japë pajtimin nga paragrafi 1 i këtij neni, qendra për punë sociale do ta njoftojë me të gjitha pasojat nga dhënia e deklaratës."

## Neni 26

Neni 108 fshihet.

## Neni 27

Në nenin 109 në radhën e parë dhe në nenin 112 paragrafi 1 fjalët: "qendra për punë sociale" zëvendësohen me fjalën "Komisioni".

## Neni 28

Në nenin 110 paragrafin 2 në radhën e dytë pas fjalës "për" shtohen fjalët: "lloji i".

Në paragrafin 3 pas fjalës "personi" shtohen fjalët: "nga qendra për punë sociale", presja dhe fjalët: "përkatësisht kujdestari" fshihen, fjala "dhe" në fund zëvendësohet me presje, ndërsa pas fjalës "adpotuesit" shtohen fjalët: "edhe kryetari i Komisionit".

## Neni 29

Në nenin 111 fjalët: "qendra për punë sociale" zëvendësohen me fjalën "Komisioni".

## Neni 30

Në nenin 117 paragrafin 2, fjalët: "dobishëm për" zëvendësohen me fjalët: "në pajtim me interesin më të mirë të".

## Neni 31

Në nenet 118 dhe 119 fjalët: "qendra për punë sociale" zëvendësohen me fjalën "Komisioni".

## Neni 32

Pas nenit 123 shtohet nen i ri 123-a si vijon:

## "Neni 123-a

Të dhënat për adoptimet e themeluara janë sekret zyrtar."

## Neni 33

Në nenin 222 pas fjalëve: "konteste nga ky ligj" shtohen fjalët: "si dhe për dhunë në martesë dhe familje".

## Neni 34

Në nenin 223 pas fjalëve: "e drejta prindore" shtohen fjalët: "edhe në rast të dhunës familjare".

## Neni 35

Pas nenit 279 shtohet kapitull i ri V-a "Procedurë për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare" dhe 8 paragrafë të rinj 279-a, 279-b, 279-v, 279-g, 279-d, 279-gj, 279-e dhe 279-zh dhe kapitull i ri V-b "Dispozitat ndëshkuese" dhe nen i ri 279-z, si vijojnë:

## "V-a

Procedurë për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare.

## Neni 279-a

Në procedurat për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare vendos gjykatësi individ.

Pas pranimit të kërkesës së nenit 94-e të këtij ligji, gjykatësi cakton senacë.

## Neni 279-b

Në procedurën nga neni 279-a të këtij ligji opinioni përjashtohet.

## Neni 279-v

Gjykata, me kërkesë të qendrës për punë sociale për shqiptimin e masës së përkohshme nga neni 94-e të këtij ligji, do të veprojë menjëherë dhe në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, do të marrë vendim.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata do të marrë vendim në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nëse ekziston dyshim i bazuar se ekziston rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e anëtarit të familjes.

## Neni 279-g

Në seancë janë të pranishëm kryerësi dhe viktimi e dhunës familjare dhe përfaqësuesi i qendrës për punë sociale.

Me vlerësim të gjykatës, mund të ftohen edhe persona të tjerë.

## Neni 279-d

Masa e përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare mund të zgjasë më së shumti një vit.

Gjykata mund të kërkojë informatë nga qendra për punë sociale për zbatimin e masës së shqiptuar.

## Neni 279-gj

Gjykata me propozim të qendrës për punë sociale, mund ta vazhdojë, shfuqizojë ose ndryshojë vendimin.

Neni 279-e

Ekzemplar nga vendimi, gjykata u dërgon palëve dhe qendrës për punë sociale, prokurorisë publike dhe organit për ndjekje.

Neni 279-zh

Ankesa e paraqitur kundër vendimit të gjykatës nuk e ndal ekzekutimin e tij.

V-b

Dispozitat ndëshkuese

Neni 279-z

Me dënim me para prej 5.000 deri 10.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje të bërë ai që nuk do të veprojë në pajtim me obligimet nga neni 94-g paragrafi 3 i këtij ligji.

Me dënim me para prej 100.000 deri 200.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje të bërë edhe personi juridik që nuk do të veprojë në pajtim me obligimet nga neni 94-g paragrafi 3 i këtij ligji.

Me dënim me para nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës në personin juridik nga paragrafi 2 i këtij neni.”

Neni 36

Dispozitat nënligjore të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 37

Komisioni nga neni 3 i këtij ligji formohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në formimin e Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni, punët e adoptimit që i përkasin pranimit të kërkesave dhe zhvillimit të procedurës për adoptim, do t'i kryejë qendra për punë sociale.

Neni 38

Procedurat për adoptim, të filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 39

Qendra për punë sociale do të bëjë dërgimin e lëndëve nga neni 38 i këtij ligji në Komision për shkak të regjistrimit në regjistrin e adoptuesve të mundshëm dhe regjistrin e të adoptuarve të mundshëm në afat prej 30 ditësh nga dita e formimit të Komisionit.

Neni 40

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë ta verifikojë tekstin e pastruar të Ligjit për familje.

Neni 41

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

**627.**

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**УКАЗ****ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ТРАНСФОРМАЦИЈА НА ПРЕТПРИЈАТИЈАТА СО ОПШТЕСТВЕН КАПИТАЛ**

Се прогласува Законот за изменување на Законот за трансформација на претпријатијата со општествен капитал,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 11 јуни 2004 година.

Бр. 07-2545/1  
11 јуни 2004 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
д-р **Љупчо Јордановски, с.р.**

**ЗАКОН****ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ТРАНСФОРМАЦИЈА НА ПРЕТПРИЈАТИЈАТА СО ОПШТЕСТВЕН КАПИТАЛ**

Член 1

Во Законот за изменување и дополнување на Законот за трансформација на претпријатијата со општествен капитал ("Службен весник на Република Македонија" број 31/2003) во членот 7 став 1 зборовите: "31 декември 2003 година" се заменуваат со зборовите: "31 декември 2004 година".

Во ставот 2 зборовите: "31 март 2004" се заменуваат со зборовите: "31 декември 2004".

Член 2

Во Законот за изменување и дополнување на Законот за трансформација на претпријатијата со општествен капитал ("Службен весник на Република Македонија" број 31/2003) во членот 8 зборовите: "31 декември 2003 година" се заменуваат со зборовите: "31 декември 2004 година."

Член 3

Во Законот за изменување и дополнување на Законот за трансформација на претпријатијата со општествен капитал ("Службен весник на Република Македонија" број 31/2003) во членовите 9, 11 став 1, 13 став 4, 14 став 2, 15 и 16 зборовите: "31 март 2004 година" се заменуваат со зборовите: "31 март 2005 година".

Член 4

Овој закон влегува во сила со денот на објавување то во "Службен весник на Република Македонија".

**L I G J I****PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE ME KAPITAL SHOQËROR**

Neni 1

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/2003) në nenin 7 paragrafi 1 fjalët: "31 dhjetor të vitit 2003" zëvendësohen me fjalët: "31 dhjetor të vitit 2004".

Në paragrafin 2 fjalët: "31 mars të vitit 2004", zëvendësohen me fjalët: "31 dhjetor të vitit 2004".

Neni 2

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/2003) në nenin 8 fjalët: "31 dhjetor të vitit 2003" zëvendësohen me fjalët: "31 dhjetor të vitit 2004".

Neni 3

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transformimin e ndërmarrjeve me kapital shoqëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/2003) në nenin 9, 11 paragrafi 1, 13 paragrafi 4, 14 paragrafi 2, 15 dhe 16 fjalët: "31 mars të vitit 2004" zëvendësohen me fjalët: "31 mars të vitit 2005".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".